



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Nr. _____ Prot

Datë 25/07/2023

PROCES VERBAL

Konsultimi për Planin Social 2024-2027

Vendi : Salla e Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak

Ora : 11:00

Tema e konsultimit : Plani social 2024-2027.

I mbajtur sot më datë 25 Korrik me pjesëmarrjen e Ekspertes mbështetëse nga UNDP për hartimin e planit znj. Marsela Dauti. Pjesëmarrjen e insitucioneve dhe grupeve të interesit për një plan sa më efikas dhe në ndihmë të komunitetit. Arjana Popapano drejtoresha e Shërbimit Social në Bashkinë Përmet nis takimin me një prezantim të përgjithshëm me të dhëna mbi Bashkinë Përmet.

Vijon me zv/kryetaren për punën e deritanishme të bërë duke marrë fjalën më pas ekspertja.

Ekspertja prezanton vështirësi që hasen në bashki si :

-Buxheti i ulët dhe moszbatimi i planit social.

-Përdorimi i planit social vetëm si plan strategjik

-Përgjegjësi e drejtorisë së shërbimeve sociale ndërkohë që kërkohet të jetë përgjegjësi e të gjithëve

-Ndërgjegjësim i ulët.

-Evidenca të ulëta/ mungesë statistikash.

-Kordinimi midis institucioneve.

-Mungesë stafi ose mbingarkesë me shumë detyra.

-Procedura burokratike për ofrimin e një shërbimi social.

Ekspertja vijon me objektivat e planit të vjetër dhe sesionet si do të veprojmë për hartimin e planit të ri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

-Kommunikimi me stafin dhe aktorët lokalë.

-Ëorkshop-et per fokusin në vazhdim.

-Përcaktimi i nevojave.

-Prezantimi i draftit të planit.

-Komente dhe konsultim me grupet.

-Publikimi.

-Finalizimi brenda muajit dhjetor.

Në vijim cdo sektor do të raportojë me të dhëna. Zv/kryetrja shpjegon që kemi punonjës social në cdo Njësi administrative të cilët evidentojnë më nga afër problemet e cdo kategorie dhe jo vetëm atyre vulnerabël.

Punonjësja e NJVKSH sqaron që njerëz me problematika dhe diagnoza të ndryshme vijnë cdo ditë, por e rëndësishme është që mos avancohet me diagnoza të tjera të reja. Më pas zhvillohen biseda me cdo individ pjesëmarrës në salle.

Vijon biseda me problematikat e mungesës së shërbimeve lëvizëse.

Punonjësja e PAK sqaron problematika që individët që trajtohen me PAK hasin si pagesat, kujdestari përkatës apo edhe transporti.

Shërbimi i psikoterapisë të ofrohet falas për këta individë.

Kryetarja e këshillit bashkiak si punonjësja e OSHEE-së sqaron problematikën e pagesave për këtë kategori.

Bashkia Përmet ka të dhëna për grupet dhe evidentimin e tyre nga cdo sektor. Kjo ishte në dakortësi dhe nga secili sektor për tu mbledhur sa më shumë.

Pjesë tepër e rëndësishme janë dhe OJF-të të cilat janë të domosdoshme për ti dhënë një shtysë zërit të target grupeve dhe komunitetit.

Zoti Ligor shtyti përfaqësues i shoqatës së personave PAK në Përmet kërkon koordinimin e të gjithave hallkave pasi problemet janë komplekse dhe e rëndësishme është zgjidhja e situatave më bazike. Një punonjës social më pranë kategorisë vulnerabël.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Një zgjidhje mund të ishte dhe një qëndër rezidenciale.

Takimi përfundon me diskutimet dhe dakordësinë për problematikat që janë hasur deri tani.

Ekspertja sqaron që do të mbetemi në kontakt për plotësimin me të dhëna të nevojshme në ditët në vijim deri në takimin e rradhës në muajin shtator 2023.

Mbyllet takimi me falenderimin për pjesëmarrjen nga Drejtorja e Shërbimit Social në Bashkinë Përmet.

Konceptoi:

Koordinatori i Konsultimit Publik

SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Denisa DURO

Foto nga takimi:





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

